

Bleta Sh.p.k
Lagjia 1, Rruga Taulantia
Prane Bashkise, Durres (AL)
Tel/Fax: +355 52 800808
E-Mail: info@bleta.net
Web-site: www.bleta.net



V E N D I M

NR Extra Viti 2022

1

MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "BLETA" SH.P.K.

Në Tiranë, sot më datë 08/12/2022 në ambientet e selisë ligjore të shoqërisë Concord Investment, në rrugën "Perlat Rexhepi", Tiranë, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "BLETA" Sh.p.k.

Shoqëria "BLETA" Sh.p.k., është regjistruar si person juridik shqiptar, me Vendim Nr. 35667, datë 05/06/2006, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NIP1 K61819510N, dhe seli të saj në adresën: rruga "Taulantia", Lagjia 1, pranë Bashkisë Durrës, Shqipëri (në vijim quajtur "Shoqëria").

Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria "BLETA" Sh.p.k., drejtohet nga Administratoria aktuale Znj. Juliana Guri.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "BLETA" Sh.p.k., është thirrur me kërkesën e aminstrotores aktuale të shoqërisë.

Administratoria aktuale e Shoqërisë, merr përsipër drejtimin e kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë, nga ku rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm, si më poshtë:

1. Concord Investment Sh.p.k 100%

që do të thotë se janë të pranishëm 100 % (njëqind për qind) e zotëruesve të kapitalit të Shoqërisë gjë që do të thotë se asambleja është thirrur rregullisht, quorumi është arritur dhe ne përputhje të plote me Ligjin nr. 9901, date 14.04 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", përkatësisht nenit 81 paragrafit 1, pika "e" dhe "i", dhe nenit 87 paragrafi 1, e vijues të tij, dhe Statutit të shoqërisë, me praninë e ortakëve është rënë dakord për të diskutuar rendin e ditës si më poshtë:

RENDI I DITËS

1. Vlerësimi i kapitalit aktual të shoqërisë
2. Diskutim për rritjen e kapitalit të shoqërisë
3. Fondet për rritjen e kapitalit
4. Të tjera

Mbasí u bë një diskutim i përgjithshëm i temave të mësipërme, shoqëria Concord Investment Sh.p.k si ortakë e shoqërisë BLETA Sh.p.k me 100% të kuotave të saj, nëpërmjet ortakëve të saj në shoqëri;

VENDOSI

1. Miratimin e rritjes së kapitalit të shoqërtisë BLETA Sh.p.k me vlerën **127.500.000** (një qind e njëzetë e shtatë million e pesëqind mijë) Lekë, duke e cuar kapitalin e shoqërisë në vlerë totale **185,000,000** (njëqind e tetë dhjetë e pesë million) Lekë.
2. Fondet e rritjes së kapitalit do të kryhen me transfertë bankare nga ortaku i shoqërisë shoqëria Concord Investment Sh.p.k, në vlerë maksimale 127.500,000 (një qind e njëzetë e shtatë million e pesëqind mijë) Lekë.
3. Sa më sipër, ky Vendim dhe dokumentacioni shoqëruar do të depozitohen pranë zyrës së regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, për t'u kryer regjistrimi përkatës. Ngarkohet Administratoria e emëruar e shoqërisë për autorizimin e personit përkatës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Asambleja e Përgjithshme
ORTAKU I VETËM

Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" Sh.p.k.

Përfaqësuar

Adrian DULAKU

Artan DULAKU

Genci DULAKU



V E N D I M

Nr. Extra Vitut 2022

I

MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

"CONCORD INVESTMENT" SH.P.K.

Në Tiranë, sot më datë 08/12/2022, në ambientet e selisë ligjore të shoqërisë, në rrugën "Perlat Rexhepi", Tiranë, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Concord Investment" Sh.p.k.

Shoqëria "Concord Investment" Sh.p.k., është regjistruar si person juridik shqiptar, me Vendim Nr. 33729, datë 14.06.2005, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NIPT K81602049K, dhe seli të saj në adresën: rruga "Perlat Rexhepi", Godina me 2+13 Kate, Kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri (në vijim quajtur "Shoqëria").

Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria "CONCORD INVESTMENT" Sh.p.k., drejtohet nga Administratori Z. Adrian Dulaku.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "CONCORD INVESTMENT" Sh.p.k., është thirrur me kërkesën e të gjithë ortakëve të shoqërisë, njëkohësisht nga ana e Administratorit të shoqërisë.

Administratori i Shoqërisë, merr përsipër drejtimin e kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë, nga ku rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm, si më poshtë:

1. **Ortaku: Adrian DULAKU**, i cili zotëron 33%(tridhjetë e tre përqind) të pjesëve të kapitalit,
2. **Ortaku: Artan DULAKU**, i cili zotëron 34%(tridhjetë e katër përqind) të pjesëve të kapitalit,
3. **Ortaku: Genci DULAKU**, i cili zotëron 33%(tridhjetë e tre përqind) të pjesëve të kapitalit,

që do të thotë se janë të pranishëm 100%(njëqind përqind) e zotëruesve të kapitalit të Shoqërisë gjë që do të thotë se asambleja është thirrur rregullisht, quorumi është arritur dhe në përputhje të plote me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", përkatësisht nenin 81 paragrafit 1, pika "e" dhe "j", dhe nenin 87 paragrafi 1, e vijues të tij, dhe Statutit të shoqërisë, me praninë e tyre wsltw rwnw dakord për të diskutuar rendin e ditës si më poshtë:

RENDI I DITËS

1. Vlerësimi i kapitalit aktual të shoqërisë Bleta Sh.p.k
2. Diskutim për rritjen e kapitalit të shoqërisë Bleta Sh.p.k
3. Fondet për rritjen e kapitalit
4. Të tjera



Mbasë u bë një diskutim i përgjithshëm i temave të mësipërme, shoqëria Concord Investment Sh.p.k si ortakë e shoqërisë BLETA Sh.p.k me 100% të kuotave të saj, nëpërmjet ortakëve të saj në shoqëri;

VENDOSI

1. Miratimin e rritjes së kapitalit të shoqërisë BLETA Sh.p.k me vlerën **127,500,000** (një qind e njëzetë e shtatë milion e pesëqind mijë) Lekë, duke e çuar kapitalin e shoqërisë në vlerë totale **185,000,000** (njëqind e tetë dhjetë e pesë milion) Lekë.
2. Fondet e rritjes së kapitalit do të kryhen me transfertë bankare nga shoqëria Concord Investment Sh.p.k, si ortaku i vetëm i shoqërisë.
3. Sa më sipër, ky Vendim dhe dokumentacioni shoqëruar do të depozitohen pranë zyrës së regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, për t'u kryer regjistrimi përkatës. Ngarkohet Administratoria e emëruar e shoqërisë BLETA Sh.p.k, për autorizimin e personit përkatës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim lyp në fuqi menjëherë.

Asambleja e Përgjithshme

Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" Sh.p.k.

Ortakët e Shoqërisë

Adrian DULAKU



Artan DULAKU



Genci DULAKU

